

TREGIMI I PEJGAMBERIT

JUNUS



Özkan Öze
Ilustroi: Sevgi İçigen

TREGIMI I PEJGAMBERIT

JUNUS



Në pamjet që ilustrojnë libërthat e kësaj serie botimesh për fëmijë nuk do të shihni asnjë nga fytyrat e pejgamberëve. Kjo sepse muslimanët nuk bëjnë portrete të pejgamberëve, për shkak të respektit që ndiejnë ndaj tyre.



BOTIMET E KRYESISË SË ÇËSHTJEVE FETARE TË TURQISË: 1706/9
Libra për fëmijë: 349/9

Drejtuesi i botimeve:

Dr. Fatih Kurt

Koordinatori i botimeve:

Lokman Arslan

Analizimi i veprës:

Hale Şahin

Elif Erdem

Editor

Zeynep Ulviye Özkan

Përktheu

Florida Kulla

Redaktor gjuhësor

Fatjon Cuka

Ndjekja e botimit

Uğur Altuntop

Botimi

Başak Mat. Tam. Hiz. İth. İhr. Tic. Ltd. Şti.

Tel.: +90 312 397 16 17

Botimi i tretë, Ankara 2019

2019-06-Y-0003-1706

ISBN 978-605-7730-91-6

Numri i certifikatës: 12930

Vendimi i komisionit të hetimit të veprave : 12.11.2019/111

© Kryesia e Çështjeve Fetare të Turqisë

Kontakt

Dini Yayınlar Genel Müdürlüğü

Yabancı Dil ve Lehçelerde Yayınlar Daire Başkanlığı


Üniversiteler Mah. Dumlupınar Bulvarı No: 147/A

06800 Çankaya - ANKARA / TÜRKİYE

Tel.: +90 312 295 72 81 • Fax: +90 312 284 72 88

E-posta: yabancidiller@diyanet.gov.tr





Një herë e një kohë na ishte një qytet i bukur me emrin Ninova.

Allahu u kishte dhënë qytetarëve të Ninovas më të bukurën e çdo gjëje:
shtëpitë më të bukura, trëndafila me aromën më të mirë dhe frutat më të ëmbla...

Por ninovasit nuk e falënderonin Allahun,
sepse e kishin harruar atë.
Ata kishin idhuj të shëmtuar.





Ninovasit falënderonin idhujt!
Vetëm Junusi nuk i adhuronte idhujt,
sepse ai falënderonte Allahun.
Sa e pakuptimtë ishte të adhuroje idhujt!
Jo! Jo! Junusi kurrë nuk i adhuronte idhujt

Dhe Allahu i dha një detyrë Junusit
Detyrën që t'u tregonte ninovasve se duhej
të besonin në Allah dhe se vetëm atë duhet të
falënderonin! Kjo ishte një detyrë e vështirë.






Junusi tha: "Idhujt nuk kanë asnjë dobi për ju!

"Mos i falënderoni kot ata!

Të gjitha këto gjëra të bukura na i dha Allahu!

Gjithsesi, askush tjetër nuk mund t'i jepte!

Vetëm Allahun falënderoni!"



Ninovasiit nuk e dëgjuan Junusin.
Madje u tallën me të
dhe u zemëruan, e goditën me gurë.
Bërtitën dhe e dëbuan nga mesi i tyre.



I thanë: "Ti mos u përziej me idhujt tanë!

Ne i duam shumë idhujt

Ata na dhanë çdo gjë ne!"

Junusi tha: "Jo, jo!

"Unë jam një i dërguar i Allahut që e ka zgjedhur
në mesin tuaj.

Unë jam një peygamber!

Ju lutem më dëgjoni, dëgjojini fjalët e mia!"

Ninovasit qeshën: "Ha! Ha! Ha!

Me sa duket je çmendur!"



Junusi u mërzit shumë dhe tha: “Këta idhuj prej guri dhe druri nuk ju dëgjojnë ju!

Madje as mund t’ju shohin! Po vazhduat të silleni kështu, Allahu do t’ju dënojë!”

Ninovasit i thanë: “Hesht, mos fol!”





Junusi u mundua dhe u përpjek për vite të tëra që të besonin në Allah.

I paralajmëroi se nëse do të vazhdonin të adhuronin idhujt,


Allahu do t'i dënonte ata,
por askush nuk e dëgjoji.


Nuk ua vunë veshin paralajmërimeve të tij.

Një ditë Junusi vendosi ta braktisë qytetin Ninova.


Por bëri një gabim, nuk priti lejen e Allahut
U largua nga qyteti Ninova, edhe pse pejgamberët
nuk e braktisin qytetin ku jetojnë, për sa kohë Allahu
nuk i lejon.

Kur iku Junusi, ninovasit u gëzuan dhe thanë:
“Më në fund! Shpëtuan nga ky burrë!”





Por gëzimi i tyre nuk zgjati shumë.
Qyteti Ninova u kaplua nga re të zeza.
Të gjithë u trembën.
Thanë: "Mjerë ne! Ndoshta Junusi kishte të drejtë!
Sa keq u sollëm ndaj tij.
Allahu duhet të yetë zemëruar me ne!"
Qanë shumë, u mërzitën shumë,
u penduan shumë
dhe bënë shumë dua.
"Allahu ynë, na fal,
Ti e do faljen!"



Allahu i fali ata. Retë e mëdha u shpërndanë.
Dielli i verdhë dhe i nxehtë i Allahut e ndriçoi sërish
qytetin Ninova.
Më pas thyen të gjithë idhujt
Po Junusi ku ishte?

Junusi kishte hipur në një anije.
Në fillim deti ishte i qetë dhe i heshtur.
Më pas nisi një furtunë.
Ata që ishin në anije u trembën shumë.
Thanë: "Njëri në mesin tonë duhet të ketë kryer një
vepër shumë të gabuar!"
Po kush ishte ai?



Kapiteni tha: "Të hedhim short!

Kujtdo që t'i bjerë shorti, ta kapim e ta hedhim në det!"

Junusi, që qëndronte i heshtur në një qoshe, tha:
"Jam unë ail!

U largova nga Ninova pa lejen e Allahut!"

Kapiteni tha: "Ti ngjan me një njeri të mirë!


Nuk mund të të hedhim në det!"

Hodhën short

Shorti i doli Pejgamberit Junus.




Më pas hodhën short edhe një herë.
Më pas edhe një herë tjetër.
Shorti i ra gjithnjë Pejgamberit Junus.
Në fund e kapën dhe e hodhën në det.
Kur Pejgamberi Junus u hodh në det furtuna pushoi,
sepse Allahu i tha që të pushojë.



Junusi kishte mbetur i vetëm në mes të detit
Ishte shumë i mërzitur. Nuk duhej ta kishte
braktisur qytetin Ninova.
Ndërkohë erdhi një peshk shumë i madh.
Peshku, i cili kishte një gojë gjigande,
e gëlltiti Pejgamberin Junus.



Barku i peshkut ishte i errët dhe i ngrohtë.
Pejgamberi Junus bëri shumë dua duke thënë:
“Allahu im! Unë gabova, më fal!”



Allahu e fali Pejgamberin Junus, sepse Allahu donte të falte ata që i kërkonin falje.



Peshku i madh ishte si një nëndetëse
dhe e ktheu Pejgamberin Junus në Ninova.
Ninovasiit u gëzuan shumë kur e panë.
Edhe Pejgamberi Junus u gëzua kur i pa ata.
Ninovasiit i kishin thyer idhujt





Sepse tashmë nuk i adhuronin ata.

Tashmë falënderonin vetëm Allahun për shtëpitë
e bukura, trëndafilat me aromë të këndshme dhe
frutat më të ëmbla...

